



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e
Komuniteteve dhe Kthim**

Legjislatura e III-të
Nr. 11/08
Prishtinë, më 22.07.2008, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e
Komuniteteve dhe Kthim

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Bojan Stojanoviq, Sanije Aliaj, Müfera Şinik, Sadik Idriz, Kosara Nikolić, Numan Balić, Zylfi Merxha, Enis Kervan, Xhevdet Neziraj, Zafir Berisha, Mursejl Haljilji.

Anëtarët jo të pranishëm: Hafize Hajdini, Hetem Arifi.

Gjithashtu të pranishëm ishin: moniturues nga OSCE.

Nga shërbimi i sekretarisë: Natasha Tisma-Prica, Arta Hajra, Vilson Ukaj.

Kryesues: Bojan Stojanoviq, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datave 13 qershor dhe 2 korrik 2008.**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.03/0114/L-020/1 për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente**
Të ftuar:
Përfaqësues nga Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe zhvillim Rural dhe Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;

4. **Rishqyrtimi i planit dhe programit të punës së Komisionit për periudhën korrik-dhjetor 2008.**
5. **Të ndryshme.**

Kryesuesi, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit i ditës miratohet pa ndryshime.

2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datave 13 qershor dhe 2 korrik 2008.**

Kryesuesi, konstatoi se procesverbali nga mbledhjet e dt.13 qershor dhe 2 korrik 2008, u miratuan pa vërejtje.

3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.03/0114/L-020/1 për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente**
Të ftuar: Përfaqësues nga Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe zhvillim Rural dhe Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryesuesi, theksoi se me gjithë formimin e grupit punues për të shqyrtuar Projektligjin nr.03/0114/L-020/1 për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore dhe për të ofruar propozimet konkrete, ata nuk janë prezentë në këtë takim. Gjithashtu konstatoi mosprezencën e të ftuarve nga komisioni (përfaqësuesit Ministrisë përkatëse dhe Komisionit funksional), për të dhënë kontributin dhe sqarimet e tyre lidhur me këtë Projektligj. Si rezultat i krijimit të një situatë të këtyllë propozoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

Sadik Idriz, konsideroi të papërgjegjshëm mospraninë e anëtarëve të grupit punues në këtë mbledhje. Më tutje vazhdoi, se nëse ata nuk vijnë, Komisioni duhet të votojë për këtë pikë të rendit të ditës, në mënyrë që mos të shtyhet, sepse edhe ashtu jemi vonuar në miratimin e këtij Projektligji.

Kryesuesi, pyeti nëse ka ndonjë propozim tjetër.

Zylfi Merxha, bëri vërejtje për mospraninë e anëtarëve të grupit punues. Njoftoi anëtarët se Komisioni funksional, pjesë e së cilit është edhe ai e ka kryer punën e tij dhe ka përgatitur materialet përkatëse, të cilat materiale u premtoi se do t'iu siguron në mbledhjen e radhës. Si rezultat i kësaj gjendje të krijuar kërkoi që Projektligji të shtyhet për shqyrtim të mëtutjeshëm dhe miratim në sesionin vjeshtor.

Sanije Aliaj, theksoi se mosrealizimi i rendit të ditës është rezultat i papërgjegjshësisë së anëtarëve të nënkomisionit. Më tutje znj. Aliaj tha se mosprania e tyre ka për qëllim prolongimin e miratimit të këtij Projektligji.

Zafir Berisha, kërkoi që të procedohet me këtë pikë të rendit të ditës, mos të bëhet prolongimi i saj. Të bëjmë vërejtjet dhe sugjerimet eventuale dhe në fund të miratohet kë Projektligj.

Kryesuesi, njoftoi anëtarët, se pavarësisht vendimit të Komisionit, kjo pikë nuk mundet të futet për shqyrtim dhe miratim për në seancën e radhës plenare, por vetëm në seancën e radhës të muajit shtator. Lidhur me mospraninë e anëtarëve të nënkomisionit, tha se nuk besoj së është bërë më qëllim të prolongimit të këtij Projektligji. Më tutje vazhdoi se ka qenë i qartë në fillim, se ky Komision nuk do të

bëhet pengesë e punës në Kuvend. Por lidhur me pikën në fjalë është duke u respektuar procedura ligjore dhe ai mundet brenda dy muajve të shqyrtohet dhe pastaj të votohet. Kërkoi trajtim të veçantë këtij Projektligji, i cili është i ndjeshëm për të gjithë qytetarët që kanë lidhje me fushën që rregullon ai. Në këtë drejtim është i domosdoshëm kontakti me sponzoruesin dhe komisionin funksional.

Sanije Aliaj, kërkoi që mos të pengohet puna e Komisionit, si rezultat i mospranisë së të ftuarve. Nëse kjo ndodh shpesë, propozoi që me një shkresë të njoftohet Kryetari i Kuvendit, për arsyet e një papërgjegjësie institucionale, e cila paraqet pengesë në punën e këtij Komisioni.

Kryesuesi, u pajtua me propozimin e znj. Aliaj për të bërë shkresë Kryetarit Kuvendit. Një shkresë e tillë mund t'i bëhet edhe Kryeministrit. Pasi që është hera e parë, të ftuarit mund të kenë arsyet e tyre. Andaj kërkoi që mos të ngritin tensionet, por në të kundërtën të mundohen të krijojnë raporte kolegjinale institucionale. Pasi që gjatë diskutimit të kësaj pike arritën dy nga tre anëtarët e grupit punues (z. Balic dhe z. Haljilji), kërkoi nga ata të marrin fjalën dhe të japin sqarimet për punën e bërë si nënkomision.

Numan Balić, theksoi se ka lexuar dhe studiuar Projektligjin, dhe pas konsultimeve që ka pasur me z. Haljilji, ka vërejtur shumë parregullsi dhe ka shumë çështje që duhet ndryshuar. Prandaj kërkoi që të bëhet rishqyrimi i gjithë Projektligjit nga anëtarët e Komisionit, në bashkëpunim me sponzoruesin dhe përfaqësuesit ndërkombëtar. Në vazhdim z. Balic paraqiti vërejtjet e tija gojore lidhur me këtë Projektligj. Theksoi se duhet ndryshuar memorandumun shpjegues. Po ashtu edhe titullin e Ligjit i cili duhet quajtur “Projektligji për verifikimin dhe shitjen e banesave”. Kjo për arsye se në fillim duhet bëhet verifikimi i banesave, i pronarëve të vërtet të tyre e pastaj shitja. Në pjesën hyrëse duhet ndryshuar disa fjali, me të cilat pronarëve të deritanishëm i’u mohet e drejta e banimit, ndërsa legalizohet e drejta për banimit atyre që janë në banesa, e që konsiderohen “uzurpatorë”. Kërkoi të ndryshohet neni 3, në mënyrë që të rregullohet e drejta e banimit të punëtorëve të mëhershëm që i kanë marrë ato banesa para lufte. Po ashtu tha se duhet ndryshohet edhe pika 4, me të cilin i’u mohohet e drejta e pronësisë ish-pronarëve. Po ashtu pjesa e përgjithshme nuk është e definuar mirë. Të sqarohet kush është blerës dhe kush shitës. Në përgjithësi duhet precizohen nocionet që përmenden në Projektligj. Kërkoi që e drejta e banimit të pronarëve legal të garantohet, kudo që gjendet banesa (përmendi rastin e firmave që kanë vepruar në teritore tjera në kushte specifike, e tanimë nuk egzistojnë). Pas nenit 6 propozoi një amendament që ndryshon dispozitat ekzistuese me këtë përmbajtje: “Ai që është pronar ka të drejtë në banesë kudo që gjendet ajo”. Titulli i nenit 7 i cili fletë për procedurën e zgjidhjes së drejtës banesore të riformulohet ashtu që, nëse nuk dihet pronari mos t’i kontestohet e drejta, deri sa kjo realisht të provohet. Njoftimi i pronarit të banesës për të bërë kërkesën për të blerë atë në afate prej dy vite, është kohë e gjatë. Kjo duhet të jetë më së shumti dy muaj, për shkak të manipulimeve që mund të ndodhin. Ndërsa sa i përket pjesës së nënshkrimit të kontratës së blerjes së banesës për tre muaj është kohë e gjatë. Propozoi që ajo të jetë 30 ditë, gjatë kësaj kohe të vërtetohet pronësia dhe të nënshkruhet kontrata. Pjesa III, duhet të ndryshoj ose të fshihet e tëra, sepse ajo parasheh humbjen e pronësisë në rast se banesat bëhen shtetërore ose rrëzohen ato. Në neni 6 të precizohet cila është puna e Ministrisë, e cila e Qeverisë. Neni 19 të rregullohet çështja e çmimit shitës. Neni 20 shumë problematikë, në këtë nen duhet të thuhet se qiramarrësit që nuk kanë paguar qiranë e kanë investuar në banesë, t’iu zbritet shuma e investuar me pjesën e qirasë që kanë borxh. Neni 22 shuma prej 30%. që rregullon vjetërsinë e banesës, të hiqet. Po ashtu duhet ndryshuar edhe pjesën përfundimtare, në mënyrë që të rregullohet drejtë çështja e drejtës banesore të pronarëve dhe uzurpatorëve.

Sadik Idriz, lidhur me komentet e z. Balic, theksoi se këto janë detyra të Komisionit funksional. Ne si Komision për Komunitete mund të bëjmë amendamente nëse mendojmë se ndonjë pozitë cenon të drejtat e komuniteteve më këtë Projektligj, përndryshe ndryshimi përmbajtësor është kompetencë e Komisionit funksional. Gjithashtu theksoi se memorandumun shpjegues nuk mund të ndryshohet, sepse ai shpjegon Projektligjin. Po ashtu lidhur me ndryshimin e titullit është një çështje komplekse për arsye se Projektligji është miratuar me këtë titull. Z. Idriz propozoi që miratimi i Projektligjit të shtyhet për në

sesionin vjeshtor dhe kërkoi që grupi punues të punojë më seriozisht, të kontaktojë me komisionin funksional dhe në fund të paraqesin propozimet dhe amendamentet në formë të shkruar, për pjesët që mendohet se prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Zafir Berisha, u pajtua me mendimet e z. Idriz që Komisioni të shqyrtojë vetëm çështjet që kanë të bëjnë interesat e komuniteteve. Ndërsa sa i përket komenteve të z. Balic, ato i konsideroi si çështje personale të tij.

Sanije Aliaj, u pajtua me parafolësin se memorandumit shpjegues nuk mund ndryshohet. Znj. Aliaj tha se brengos fakti i shtyrjes së miratimit të këtij Projektligji pa i precizuar arsyet konkrete. Kërkoi si anëtarë të jenë me seriozë dhe të bëhen propozimet konkrete dhe me shkrim dhe të amendamentohen ato pjesë, të cilat konsiderohen se shkelin interesat e komuniteteve.

Numan Balić, lidhur me komentet e z. Berisha se qasje e ndaj Projektligjit është çështje individuale, nuk është e vërtetë. Qëllimi i ndryshimeve është rregullimi i çështjes së banimit dhe legalizimi i pronarëve të vërtetë për të gjithë qytetarët e Kosovës. Theksoi se nëse nuk bëhen ndryshimet nuk do të përkrah miratimin e tij.

Xhevdet Neziraj, theksoi se krijimi i grupit punues është bërë më qëllim të sqarohen shumë gjëra në dhe të bëhen propozimet konkrete dhe në bashkëpunim me komisionin funksional të zgjidhen problemet që mund të ketë ky Projektligj. Duke pasur parasysh faktin se kjo nuk ka ndodhur, kërkoi që të gjithë anëtarët, por në veçanti grupi punues të vë kontaktet me komisionin funksional dhe të përgatis amendamentet konkrete dhe të miratohet ky Projektligj, ashtu edhe i vonuar.

Mursejl Haljilji, lidhur me Projektligjin, tha se ka biseduar me telefon me z. Balic dhe janë akorduar se ai ka gabime të shumta dhe duhet ndryshuar. Kërkoi që mos të nguten në miratimin e tij. Grupi punues do t'i përgatit amendamentet me shkrim në mbledhjet tjera. Kërkoi që edhe anëtarët tjerë të japin kontributin e tyre sepse Projektligji është në të mirën e të gjithë qytetarëve të Kosovës. Të rregullohet mirë e drejta e pronësisë së banesës dhe e pronarëve të vërtetë.

Kryesuesi, kërkoi që mos të nguten në miratimin e këtij Projektligji. Theksoi se Projektligji ka nevojë për plotësim dhe ndryshim, të rregullohet mirë e drejta e banimit. Komentet e z. Balic janë një bazë e mirë për të punuar. Prandaj propozoi t'i epet mundësia grupit punues të parashtrij propozimet konkrete me shkrim dhe të bëhen amendamentet për ato dispozita të cilat konsiderohen se shkelin të drejtat e komuniteteve. Kryesuesi tha se shumë gjëra nuk më duken në rregull dhe kështu siq është nuk mund ta votojë. Të mos miratojmë Ligjin i cili duhet kthyer prapë për plotësim dhe ndryshim. Përndryshe në rast vërehet se shkelën të drejtat e komuniteteve edhe kushtetua garanton të drejtën e votimit të dyfishtë.

Numan Balić, kërkoi që anëtarët të japin propozimet e tyre, ndërsa nënkomision të vazhdojë punën dhe të del me amendamente konkrete. Deri më tani kam paraqitur peshën e problemit dhe kam menduar që bashkërisht të bëjmë ndryshimet e nevojshme në këtë Projektligj.

Sanije Aliaj, lidhur me mbrojtjen e interesave të komuniteteve, kërkoi që të bëjnë propozime konkrete. Sipas saj është i domosdoshëm bashkëpunimi me komisionin funksional. U pajtua që të shtyhet, por në mbledhjen e radhës grupi punues të del me propozimet konkrete në formë amendamenteve dhe të votohet kë Projektligj.

Zylfi Merxha, lidhur me propozimet për ndryshim, kërkoi të bëhen amendamentet ku mendohet se prekin interesat e komuniteteve. Nëse Projektligji ka shumë gabime përmbajtësor, të rekomandohet kthimi sponzoruesi. Z. Merxha u pajtua të bashkëpunohet me komisionin funksional në mënyrë që të evitohen paqartësitë e këtij Projektligji.

Kryesuesi, konstatoi se nga diskutimi shihet nevoja e shtyrjes së miratimit të këtij Projektligji për në sesionin vjeshtor, andaj obligohet grupi punues që të vazhdoj punën, të kontaktojë me sponsoruesin dhe komisionin funksional dhe të propozojë amendamentet konkrete, të cilat do të shqyrtohen dhe miratohen në Komision.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, me votimin të bërë Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Shtyhet shqyrtimi dhe miratimi i Prokjektligjit nr.03/0114/L-020/1 për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente për në mbledhjen e ardhshme të Komisionit.
- II. Obligohet grupi punues që të vazhdoj punën, të kontaktojë me sponsoruesin dhe komisionin funksional dhe të propozojë amendamentet konkrete, të cilat do të shqyrtohen dhe miratohen në Komision.

4. Rishqyrtimi i planit dhe programit të punës së Komisionit për periudhën korrik-dhjetor 2008.

Sanije Aliaj, bëri vërejtje për mosrealizimin planit të punës deri më tani, sidomos rreth vizitave të cilat nuk janë bërë. Në këtë drejtim kërkoi që Komisioni që më shkresë të kërkohet nga kuvendet komunale të jenë më të përgjegjshme dhe të respektohet autoriteti që ka ky Komision.

Kryesuesi, u pajtua me znj. Aliaj që të kërkohet përgjegjësi nga kuvendet komunale, për ofrimin e mundësisë së Komisionit për realizimin e planit të tij. Premtoi se me shkresë zyrtare do të kërkohet nga ata një përgjegjësi e tillë.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, me votimin të bërë Komisioni njëzëri nxori këtë:

V E N D I M

Miratohet plani gjashtë mujor (korrik-dhjetor 2008) i punës, me mundësi të plotësimin dhe ndryshimit të tij, varësisht nga aktivitetet prioritare që ka Komisioni.

5. Të ndryshme

Sanije Aliaj, lidhur me mosprezencën e të ftuarve, kërkoi që Komisioni me shkresë të njoftoj Kryetarin e Kuvendit në mënyrë që të kërkoj nga të gjithë institucionet, të respektohet autoriteti që ka ky Komision.

Kryesuesi, mbështeti propozimin e znj. Aliaj dhe premtoi se me shkresë do të kërkoj nga të gjitha institucionet, që të jenë më të përgjegjshëm në respektimin e kompetencave dhe autoritetit që ka ky Komision në çështjet e të drejtave dhe interesave të komuniteteve

Mbledhja përfundoi në ora 14:50

Përgatitur nga
Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit

Bojan STOJANOVIĆ